EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8428
E martë, 10 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Prova të reja konfirmuese për fushën antimagnetike

FAQE 2

Shkruan:
Naim KRASNIQI,
fizikan



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ARSIM BAJRAMI PROPOZON KOMISION SHTETËROR TË EKSPERTËVE JURIDIKË PËR MBROJTJEN E KRERËVE TË UÇK-së NË APEL

FAQE 4-5



Akademiku Arsim Bajrami ka propozuar mobilizimin e ekspertizës juridike vendore dhe angazhim të koordinuar institucional të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e krerëve të UÇK-së në Dhomat e Specializuara në Hagë. Ai ka paraqitur tetë propozime konkrete për veprim institucional, duke theksuar se Kosova duhet të kalojë nga mobilizimi politik në një angazhim të organizuar juridik dhe profesional. Bajrami ka vlerësuar se faza e ardhshme e ankimimit ndaj aktgjykimit të shkallës së parë përbën një nga sfidat më të rëndësishme juridike dhe institucionale për Kosovën, duke theksuar se përpjekjet duhet të përqendrohen në argumente profesionale, prova konkrete dhe identifikimin e shkeljeve të mundshme procedurale dhe materiale

PLANI AMERIKAN PËR SIGURINË E EVROPËS: ÇFARË MUND TË NDRYSHOJË PËR KOSOVËN?

F. 7



GREVA PËR PAGA LË KOSOVËN PA TRANSPORT HEKURUDHOR

F. 6



AKTUALE



EURODEPUTETI ITALIAN GIORGIO GORI KËRKON SHPJEGIME PËR PARABURGIMIN E ZGJATUR TË ERION VELIAJT

F. 2

KURTI NË PARIS VIZITON 'STATION F', KOMPLEKSIN MË TË MADH NË BOTË PËR STARTUP-e

F. 2

ÇITAKU PRITI DELEGACIONIN E INSTITUTIT REPUBLIKAN, BISEDUAN PËR FORCIMIN E DEMOKRACISË DHE BASHKËPUNIMIN E NDËRSJELLË

F. 2

EKONOMI



AKB-JA: KOSOVA RRITET NË PËRQINDJE, POR MBETET PRAPA NË FUQINË EKONOMIKE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

F. 3

DERI NË 100 MW KAPACITETE TË REJA NGA ERA, HAPEN OFERTAT FINANCIARE TË ANKANDIT TË PARË

F. 7

SPORT



FODA: SYNOJMË TA FITOJMË NDESHJEN ME IZRAELIN, TË RINJTË JANË E ARDHMJA E KOMBËTARES

F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Eurodeputeti italian Giorgio Gori kërkon shpjegime për paraburgimin e zgjatur të Erion Veliajt

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Eurodeputeti italian Giorgio Gori ka kërkuar shpjegime lidhur me rastin e paraburgimit të zgjatur të kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj. Në një deklaratë për gazetën "Domani", ai ka deklaruar se rasti Veliaj "do të ngrihet edhe në Parlamentin Evropian" dhe se i ka kërkuar zyrtarisht sqarime përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme, Kaja Kallas.

"Nuk kam informacion të mjaftueshëm për ta gjykuar pafajësinë apo fajësinë e Veliajt, por prirem ta mbështes parimin e prezumimit të pafajësisë dhe, në këtë rast, mungojnë garancitë minimale. Në këtë rast nuk është zhvilluar as seancë dëgjimore. Rasti bën pjesë në problematikën e paraburgimit, që më duket mjaft patologjike në Shqipëri. Një pjesë e madhe e popullsisë së burgjeve mbahet pas hekurave pa pasur një dënim të formës së prerë. Kjo është një çështje që duhet të ngrihet gjatë negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, të cilat, megjithatë, po përparojnë pozitivisht. Sigurisht që ka pasur përparime. Por personat nën hetim nuk mund të mbahen në burg. Rasti Veliaj do të ngrihet edhe në Parlamentin Evropian", ka theksuar Gori, e cila deklaratë është shpërndarë në profilin e Veliajt në "Facebook".



KURTI NË PARIS VIZITON 'STATION F', KOMPLEKSIN MË TË MADH NË BOTË PËR STARTUP-e

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar kompleksin e njohur të teknologjisë dhe inovacionit 'STATION F' në Paris të Francës, ku është njoftuar nga afër me kompani dhe iniciativa të ndryshme në fushën e teknologjisë, inteligjencës artificiale dhe inovacionit.

Në "Facebook", Kurti ka bërë me dije se 'STATION F' është një prej qendrave më të mëdha në botë për startup-e, e cila funksionon në një ndërtesë historike që dikur shërbente si depo kryesore mallrash dhe stacion trenash në kryeqytetin francez. "Një ndërtesë njëshekullore, që ishte ngritur dhe kishte shërbyer si depo kryesore mallrash e stacion trenash në Paris deri në vitin 2000 kur ishte mbyllur, tash e mëse një dekadë është qendër e teknologjisë dhe invocacionit. Me rreth 34 mijë metra katrorë hapësirë, dhe brenda saj, me më shumë se 700 investitorë, me qasje për më shumë se 9,000 startup-e dhe më shumë se 30 programe, 'STATION F' është aktualisht kampusi dhe inkubatori më i madh në botë për startup-e", ka shkruar Kurti.

Kurti, po ashtu, ka shkruar se aty patën mundësi të takohen me përfaqësues kompanish që



veprojnë në mes administratës publike, shkencës së sjelljes dhe inteligjencës artificiale, nëpërmjet zhvillimit të platformave të integruara për mbështetjen e vendimmarrjes dhe hartimin e politikave publike, por edhe me të tjera të teknologjisë së mbrojtjes (Defence Tech), të specializuara në zhvillimin e sistemeve autonome nënujore dhe dronëve detarë për mbrojtjen e flotave ushtarake, porteve dhe infrastrukturës kritike ujore.

"TIK është nga sektorët më dinamik të ekonomisë sonë dhe aktualisht përbën 6 për qind të Bruto Produktit Vendor. Potenciali është më i madh se kaq, andaj ndërtimi i një ekosistemi, krahas bashkëpunimit, shkëmbimeve, përvojave dhe partneriteteve me ekspertë e qendra të tilla, i shërben përmbushjes së tij", ka shkruar Kurti.

TAHIRI: MBI NJË MILIARD EURO TË SHPENZUARA PËR ENERGJI, TË ENJTEN DO TË HAPIM DEBAT PARLAMENTAR PËR KRIZËN



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës, Besnik Tahiri, ka ngritur shqetësimin për gjendjen në sektorin e energjisë në Kosovë, duke kërkuar përgjegjësi dhe llogaridhënie për krizën energjetike.

Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Tahiri ka deklaruar se energjia mbetet çështja kyçe për Kosovën dhe ekonominë e saj. Ai ka theksuar se mbi një miliard euro janë shpenzuar për blerjen e energjisë elektrike, ndërsa ka kritikuar varësinë e madhe nga importi, çmimin e lartë të rrymës dhe, siç është shprehur, dështimin për renovimin e njësisë B1 për gjashtë vjet. Sipas Tahirit, këto çështje kërkojnë përgjegjësi dhe llogaridhënie dhe nuk duhet të mbeten vetëm në duart e Prokurorisë, por duhet të trajtohen edhe përmes hetimit dhe debatit parlamentar.

Ai ka bërë me dije se të enjten do të hapet debat në Kuvend për këtë çështje.

Tahiri ka vlerësuar se kriza energjetike po i dëmton drejtpërdrejt qytetarët dhe po e frenon zhvillimin ekonomik të Kosovës. "Energjia nuk është vetëm çështje e rrymës, por e ekonomisë, e mirëqenies së qytetarëve dhe e së ardhmes së Kosovës", ka theksuar Tahiri.

Presidentja Shiroka-Pula pret delegacionin e RrGK-së, diskutohet parandalimi i dhunës dhe femicidi

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula, priti në takim një delegacion të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), kryesuar nga Nermin Mahmuti, kryetare e Bordit të RrGK-së.

Përfaqësueset e RrGK-së e uruan presidenten për detyrën dhe shprehën gatishmërinë për bashkëpunim për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të grave.

Në takim u diskutua për masat konkrete që duhet të ndërmerren për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vrasjeve të tyre.

Përfaqësueset e RrGK-së propozuan përfshirjen e femicidit në Kodin Penal, fuqizimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave, fuqizimin ekonomik, si dhe rritjen e buxhetit për punëtorët socialë dhe shërbimet e specializuara për mbrojtjen e grave.

Presidentja Shiroka-Pula vlerësoi rëndësinë e punës së RrGK-së dhe të organizatave të shoqërisë civile në adresimin e dhunës ndaj grave. Ajo shprehu gatishmërinë për t'i mbështetur përpjekjet e tyre, duke theksuar nevojën për veprime konkrete, koordinim institucional dhe angazhim të vazhdueshëm për ta garantuar sigurinë dhe të drejtat e grave.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

AKB-ja: KOSOVA RRITET NË PËRQINDJE, POR MBETET PRAPA NË FUQINË EKONOMIKE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 9 nëntor - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), bazuar në të dhënat dhe projeksionet e institucioneve ndërkombëtare për vitin 2026, ka përgatitur një analizë krahasuese të ekonomive të Ballkanit Perëndimor, e cila evidenton dallimet në madhësinë e ekonomive, GDP-në për kokë banori dhe ritmet e rritjes ekonomike. "Sipas projeksioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për vitin 2026, ekonomia e Kosovës vlerësohet në rreth 14.15 miliardë dollarë, ndërsa Serbia arrin 111.2 miliardë, Bosnja dhe Hercegovina 37.26 miliardë, Shqipëria 32.77 miliardë, Maqedonia e Veriut 21.24 miliardë dhe Mali i Zi 10.12 miliardë dollarë. Edhe në GDP-në nominale për kokë banori, Kosova mbetet në nivelin më të ulët në mesin e gjashtë ekonomive të rajonit, me rreth 8,900 dollarë sipas projeksioneve të FMN-së për vitin 2026", theksohet në analizën e AKB-së.

Nga ana tjetër, sipas Bankës Botërore, Kosova pritet të shënojë rritje reale ekonomike prej 3.6 % gjatë vitit 2026, duke dëshmuar potencial për rritje. "Megjithatë, rritja ekonomike në përqindje nuk duhet ngatërruar me fuqinë reale të ekonomisë, madhësinë e prodhimit, produktivitetin dhe nivelin e mirëqenies", thuhet në këtë analizë.

AKB-ja vlerëson se sfida kryesore e Kosovës nuk është vetëm rritja e GDP-së, por shndërrimi i kësaj rritjeje në zhvillim të qëndrueshëm, prodhim vendor dhe konkurrueshmëri ekonomike.

Për këtë arsye, AKB-ja kërkon nga institucionet e Kosovës që politikat ekonomike të orientohen drejt: Rritjes së prodhimit vendor dhe fuqizimit të industrisë përpunuese; Zgjerimit të eksporteve dhe zvogëlimit të deficitit tregtar; Nxitjes së investimeve vendore dhe të huaja; Sigurimit të energjisë së qëndrueshme dhe me çmime konkurruese; Rritjes së produktivitetit dhe aftësimit profesional të fuqisë punëtore; Digjitalizimit dhe modernizimit të ndërmarrjeve; Lehtësimit të tregtisë dhe eliminimit të barrierave rajonale.



Sipas analizës së AKB-së, Banka Botërore vlerëson se eliminimi i gjysmës së barrierave të mbetura tregtare në rajon mund të rrisë GDP-në deri në 12.5 % në periudhën afatmesme. Ky potencial duhet të shndërrohet në mundësi konkrete për bizneset dhe ekonominë e Kosovës.

Kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka theksuar se mesazhi i AKB-së është i qartë: Kosovës i duhet më shumë prodhim, më shumë eksporte, më shumë investime dhe më shumë produktivitet! "Nuk mjafton të shënojmë rritje ekonomike në statistika, nëse kjo rritje nuk reflektohet në fuqizimin e ndërmarrjeve, hapjen e vendeve të reja të punës, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. AKB-ja kërkon një partneritet të mirëfilltë ndërmjet Qeverisë, institucioneve dhe sektorit privat për hartimin e një programi zhvillimor deri në vitin 2030, me objektiva të matshme dhe mbështetje konkrete për bizneset. Kosova duhet të kalojë nga ekonomia e konsumit dhe importit drejt një ekonomie të prodhimit, eksportit dhe konkurrueshmërisë", ka deklaruar Shahini.

ÇITAKU PRITI DELEGACIONIN E INSTITUTIT REPUBLIKAN, BISEDUAN PËR FORCIMIN E DEMOKRACISË DHE BASHKËPUNIMIN E NDËRSJELLË



Prishtinë, 9 nëntor - Ushtruesja e detyrës së kryetares së Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, ka pritur në takim një delegacion të Institutit Republikan Ndërkombëtar (IRI), të kryesuar nga drejtori për Evropë dhe Euroazi, Stephen Nix.

Gjatë takimit Çitaku shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe kontributin e IRI-së në forcimin e demokracisë së brendshme në PDK, si dhe në mbështetjen e zhvillimit demokratik të partive politike dhe institucioneve të Kosovës në përgjithësi.

Çitaku theksoi se PDK po hyn në një periudhë të rëndësishme të organizimit të brendshëm, gjatë së cilës do ta zgjedhë lidershipin e ri dhe do të përgatitet për përgjegjësitë dhe sfidat e ardhshme politike.

Drejtori Nix shprehu gatishmërinë e IRI-së për ta vazhduar mbështetjen për proceset demokratike në Kosovë dhe më gjerë, duke theksuar rëndësinë e institucioneve të qëndrueshme dhe të pjesëmarrjes aktive në jetën politike.

Çitaku ritheksoi se vlerat e përbashkëta që promovojnë PDK dhe IRI, liria, pluralizmi politik, sundimi i ligjit dhe llogaridhënia, përbëjnë një bazë të fortë për qëndrueshmërinë e demokracive liberale përballë sfidave të sotme globale.

HOTI: QEVERIA PO MASHTRON PUBLIKUN ME SHIFRAT E LARTA TË INVESTIMEVE KAPITALE, PROJEKTET NUK PO REALIZOHEN

Prishtinë, 9 nëntor - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se kjo qeveri po e mashtron veten dhe publikun me buxhet të madh të planifikuar për investime kapitale. Ai ka thënë se shifrat e larta të buxhetit po përdoren vetëm për krekosje me rastin e miratimit të buxhetit në Kuvend. "Kur po vjen koha për të raportuar në Kuvend për realizimin e buxhetit, asnjë anëtar i qeverisë nuk del para deputetëve dhe qytetarëve të përgjigjet për dështimet në realizimin e projekteve. Në gjashtë vitet e fundit, realizimi i investimeve kapitale ka qenë tejet i ultë. Asnjë nga projektet e mëdha kapitale të trashëguara nga qeveritë paraprake dhe të nisura para vitit 2021 nuk është realizuar, përfshirë këtu autostradën e Gjilanit, rrugën për Pejë, rrugën për Mitrovicë, rrugën për Podujevë, rrugën Dollc-Gjakovë, rrugën Prizren-Gjakovë etj", ka shkruar Hoti në



"Facebook".

Ai ka thënë se as projektet e premtuar nga kjo qeveri nuk janë realizuar, përfshirë këtu: rrugën dhe tunelin Prizren-Tetovë, hekurudhën Prishtinë-Durrës, aeroportin e Gjakovës, çerdhet për fëmijë, banesat sociale, digat për akumulime dhe projekte të tjera. "Kështu që, askush nuk beson më në shifrat e larta të investimeve kapitale të parapara në buxhetin e vitit 2027. Realizimi i buxhetit për investime kapitale ka mbetur i ulët edhe pse procedurat e prokurimit janë kryer në shumë raste përmes negocimit, siç dëshmohet me qindra e mijëra tenderë njëburimorë apo me negocim. Pasojat ekonomike dhe sociale nga mosrealizimi i projekteve kapitale po i bartim të gjithë. Kolonat e gjata nëpër rrugë në ndërtim e sipër tash e gjashtë vite po i kushtojnë secilit kohë dhe shpenzime. Mosrealizimi i investimeve kapitale e kanë lënë ekonominë e Kosovës pa qindra miliona euro në qarkullim, mjete që do të krijonin efekte zinxhirore pozitive në ekonomi", ka deklaruar ish-kryeministri Avdullah Hoti.

FSK-ja, pjesë e trajnimit ndërkombëtar në Kroaci

Prishtinë, 9 nëntor - Forca e Sigurisë së Kosovës ishte pjesë e trajnimit ndërkombëtar "Training Based on SOP - Standards of Interventions", i cili u realizua në Slunj të Kroacisë me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të Togut për Intervenime nga Policia Ushtarake e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Trajnimi u udhëhoq dhe u realizua nga instruktorë të Ushtrisë Kroate të Njësisë Kundër Terrorizmit të Policisë Ushtarake Kroate.

Gjatë këtij trajnimi u zhvilluan aktivitete të ndryshme praktike, me fokus në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe avancimin e shkathtësive në fushën e intervenimeve.

Përmes këtyre aktiviteteve u mundësua avancimi i shkathtësive taktike, shkëmbimi i përvojave profesionale dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.

Pjesëmarrja në trajnime të tilla dëshmon përkushtimin e FSK-së në ngritjen e vazhdueshme të profesionalizmit, gatishmërisë dhe kapaciteteve operacionale të pjesëtarëve të saj.





ARSIM BAJRAMI PROPOZON KOMISION SHTETËROR TË EKSPERTËVE JURIDIKË PËR MBROJTJEN E KRERËVE TË UÇK-së NË APEL

Akademiku Arsim Bajrami ka propozuar mobilizimin e ekspertizës juridike vendore dhe angazhim të koordinuar institucional të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e krerëve të UÇK-së në Dhomat e Specializuara në Hagë. Ai ka paraqitur tetë propozime konkrete për veprim institucional, duke theksuar se Kosova duhet të kalojë nga mobilizimi politik në një angazhim të organizuar juridik dhe profesional. Bajrami ka vlerësuar se faza e ardhshme e ankimimit ndaj aktgjykimit të shkallës së parë përbën një nga sfidat më të rëndësishme juridike dhe institucionale për Kosovën, duke theksuar se përpjekjet duhet të përqendrohen në argumente profesionale, prova konkrete dhe identifikimin e shkeljeve të mundshme procedurale e materiale

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Akademiku Arsim Bajrami ka propozuar mobilizimin e ekspertizës juridike vendore dhe angazhim të koordinuar institucional të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e krerëve të UÇK-së në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Në një shkrim të publikuar më 9 nëntor në rrjetet sociale, Bajrami ka vlerësuar se faza e ardhshme e ankimimit ndaj aktgjykimit të shkallës së parë përbën një nga sfidat më të rëndësishme juridike dhe institucionale për Kosovën, duke theksuar se përpjekjet duhet të përqendrohen në argumente profesionale, prova konkrete dhe identifikimin e shkeljeve të mundshme procedurale e materiale.

Sipas Bajramit, ky komision do të kishte për detyrë ta analizonte aktgjykimin e shkallës së parë, t'i identifikonte shkeljet e mundshme juridike, ta shqyrtonte vlerësimin e provave dhe përgjegjësinë individuale penale, si dhe të përgatiste një ekspertizë gjithëpërfshirëse në mbështetje të ekipeve të mbrojtjes.

Ai propozon që ky dokument juridik të përfundojë brenda muajit nëntor dhe t'u vihet në dispozicion avokatëve të të akuzuarve, pa penguar apo vonuar afatet e dorëzimit të ankesave.

Bajrami thekson se strategjia e mbrojtjes në shkallën e dytë duhet të përqendrohet në kundërshtimin e konstatimeve faktike, analizën e besueshmërisë së dëshmitarëve, përgjegjësinë individuale penale, strukturën organizative dhe komanduese të UÇK-së, si dhe pretendimet për ekzistencën e një plani apo qëllimi kriminal.

Një rëndësi të veçantë ai i kushton edhe identifikimit të dëshmitarëve dhe provave shtesë që mund të pranohen në procedurën ankimore, duke kërkuar që mbrojtja të ndërtojë një bazë më të fuqishme provuese.

Në propozimin e tij, akademiku Bajrami kërkon gjithashtu angazhim diplomatik të institucioneve të Kosovës, përkatësisht presidentes, kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme, për të komunikuar me shtetet donatore të Dhomave të Specializuara dhe shtetet mike të Kosovës. Ai propozon edhe monitorim të pavarur ndërkombëtar për respektimin e standardeve të gjykimit të drejtë, përfshirë prezumimin e pafajësisë, barazinë e armëve dhe të drejtën për mbrojtje efektive.

Si shembull për analizë juridike, Bajrami përmend rastin e gjeneralëve kroatë Ante Gotovina dhe Mladen Markač, të cilët fillimisht ishin dënuar në shkallën e parë nga Tribunali i Hagës, por më 16 nëntor 2012 u liruan nga Dhoma e Apelit.

Në përfundim ai ka paraqitur tetë propozime konkrete për veprim institucional, duke theksuar se Kosova duhet të kalojë nga mobilizimi politik në një angazhim të organizuar juridik dhe profesional. "Lufta e UÇK-së duhet të mbrohet përmes së vërtetës historike, ndërsa pafajësia e të akuzuarve duhet të argumentohet përmes provave dhe standardeve të së drejtës penale", ka shkruar Bajrami.

Ai ka theksuar se kjo fazë kërkon seriozitet, profesionalizëm dhe koordinim institucional pasi, sipas tij, Kosova nuk ka kohë për të humbur.

SHKRIMI I PLOTË I AKADEMIK ARSIMIT BAJRAMIT:

BETEJA JURIDIKE PËR MBROJTJEN E KRERËVE TË UÇK-SË NË DHOMAT E APELIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA (7)

Propozim për mobilizimin e ekspertizës juridike vendore dhe për një angazhim të koordinuar institucional të Republikës së Kosovës

1. Beteja e ardhshme është ekskluzivisht juridike

Me afrimin e fazës së ankimimit ndaj aktgjykimit të shkallës së parë në Dhomat e Specializuara të Kosovës, duhet të kuptohet qartë se procesi i ardhshëm përbën një nga sfidat më të rëndësishme juridike, institucionale dhe historike për Republikën e Kosovës. Në këtë fazë, beteja duhet të zhvillohet para së gjithash në rrafshin juridik, përmes argumenteve profesionale, provave konkrete, analizës kritike të aktgjykimit dhe identifikimit të të gjitha shkeljeve të mundshme materiale dhe procedurale të gjykimit të shkallës së parë. Kosova nuk ka më kohë për të humbur. Nuk kemi kohë për pritje, për deklarata politike të përsëritura apo për debate që nuk prodhojnë rezultate konkrete juridike. Nuk duhet të presim përfundimin e strategjive të përgjithshme politike, ndërkohë që ekipet e mbrojtjes kanë përpara afate të kufizuara dhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë për përgatitjen e parashtresave ankimore. Duhet të kuptohet se mbrojtja e pafajësisë së të akuzuarve nuk mund të realizohet vetëm përmes deklaratave politike, protestave apo vlerësimeve historike për luftën e UÇK-së. Ajo duhet të argumentohet përmes mjeteve të së drejtës penale, së drejtës penale ndërkombëtare, provave bindëse dhe standardeve të gjykimit të drejtë. Prandaj, në këtë moment, Kosova duhet ta zhvendosë qendrën e angazhimit të saj nga mobilizimi politik në mobilizimin juridik dhe profesional.

2. Ngritja urgjente e një komisioni shtetëror të ekspertëve juridikë

Masa e parë dhe më urgjente që duhet të ndërmarrë Republika e Kosovës është krijimi i një komisioni të posaçëm ekspertësh juridikë, me mandat të qartë, përbërje profesionale dhe afat të kufizuar kohor. Ky komision duhet të përbëhet nga gjyqtarë dhe ish-gjyqtarë me përvojë të dëshmuar, prokurorë, avokatë penalistë, profesorë të së drejtës penale dhe ekspertë të së drejtës penale ndërkombëtare, të cilët kanë kompetencë profesionale për të analizuar në mënyrë kritike aktgjykimin dhe procesin gjyqësor. Komisioni duhet të jetë profesional, pluralist, i pavarur në vlerësimet e tij dhe i çliruar nga ndikimet partiake dhe kalkulimet politike.
Mandati i tij duhet të jetë konkret:
* Të bëjë analizën e plotë juridike të aktgjykimit të shkallës së parë.
* Të identifikojë shkeljet e mundshme të së drejtës materiale dhe procedurale.
* Të analizojë mënyrën e administrimit, vlerësimit dhe interpretimit të provave.
* Të shqyrtojë nëse përgjegjësia individuale penale është provuar sipas standardit të kërkuar.
* Të analizojë bazën juridike të pretendimeve për përgjegjësi komanduese dhe format e tjera të përgjegjësisë penale.
* Të identifikojë kundërthëniet ndërmjet provave, dëshmive dhe konstatimeve të trupit gjykues.
* Të shqyrtojë mundësitë procedurale për paraqitjen e provave shtesë dhe dëgjimin e dëshmitarëve të rinj në apel.
* Të përgatisë një dokument gjithëpërfshirës juridik, i cili mund t'u vihet në dispozicion ekipeve të mbrojtjes si ekspertizë plotësuese për përgatitjen e ankesave.
Ky dokument duhet të jetë një ekspertizë juridike kosovare, e ndërtuar mbi analizën e provave, legjislacionit të zbatueshëm, praktikës gjyqësore dhe standardeve ndërkombëtare. Ekspertiza juridike vendore ka rëndësi të veçantë, sepse ekspertët kosovarë njohin drejtpërdrejt kontekstin historik, institucional, politik dhe juridik në të cilin është zhvilluar lufta e UÇK-së. Një kusht thelbësor është që puna e komisionit të zhvillohet paralelisht dhe në koordinim profesional me ekipet e mbrojtjes, pa pritur përfundimin e dokumentit të tij. Afatet individuale të ankimimit duhet të respektohen në çdo rrethanë. Dokumenti i komisionit duhet të shërbejë si material plotësues për mbrojtjen dhe jo si kusht apo pengesë për dorëzimin me kohë të ankesave. Për këtë arsye, propozoj që komisioni të fillojë punën menjëherë dhe ta përfundojë ekspertizën brenda muajit nëntor, në përputhje me afatet konkrete procedurale.

3. Drejtimet themelore të mbrojtjes juridike në shkallën e dytë

Strategjia ankimore duhet të jetë ofensive, sistematike dhe e mbështetur në prova. Ajo nuk duhet të kufizohet në kundërshtime të përgjithshme ndaj aktgjykimit, por duhet të sfidojë në mënyrë të individualizuar çdo pikë të akuzës dhe çdo përfundim juridik të trupit gjykues.
Mbrojtja duhet të përqendrohet në këto çështje themelore:
Së pari, konstatimi i gabuar ose i paplotë i gjendjes faktike.
Duhet të analizohet nëse trupi gjykues i ka vlerësuar drejt provat e administruara, nëse ka nxjerrë përfundime që nuk mbështeten në prova të mjaftueshme dhe nëse ka injoruar prova që mund të jenë vendimtare për pafajësinë e të akuzuarve. Çdo pikë e aktakuzës duhet të shqyrtohet veçmas. Për secilin pretendim duhet të identifikohen faktet që e mbështesin, faktet që e kundërshtojnë dhe mangësitë në arsyetimin e trupit gjykues.
Së dyti, kundërshtimi i përgjegjësisë individuale penale.
Duhet të argumentohet se përgjegjësia penale është individuale dhe se ajo nuk mund të ndërtohet mbi pozita politike, reputacion publik, funksione ushtarake apo supozime të përgjithshme për ndikimin e të akuzuarve. Në veçanti, duhet të shqyrtohen elementet juridike të secilës formë të përgjegjësisë penale që u është atribuuar të akuzuarve, përfshirë përgjegjësinë individuale, përgjegjësinë komanduese dhe format e përgjegjësisë së përbashkët, nëse ato janë zbatuar në aktgjykim. Duhet të analizohet nëse janë vërtetuar të gjitha elementet përbërëse të veprave penale dhe nëse është provuar lidhja juridike dhe faktike ndërmjet veprimeve konkrete të secilit të akuzuar dhe krimeve për të cilat është dënuar.
Së treti, analiza kritike e provave dhe besueshmëria e dëshmitarëve.
Mbrojtja duhet të analizojë me kujdes besueshmërinë, qëndrueshmërinë, koherencën dhe përputhshmërinë e dëshmive me provat e tjera materiale. Duhet të shqyrtohet prejardhja e dëshmive, kushtet në të cilat janë marrë, mundësia e ndikimit mbi dëshmitarët, kundërthëniet ndërmjet deklaratave të tyre dhe çdo element tjetër që mund të ndikojë në besueshmërinë e provave. Asnjë dëshmi nuk duhet të pranohet si e pakontestueshme vetëm për shkak se është paraqitur nga një dëshmitar i caktuar. Ajo duhet të vlerësohet në kontekstin e tërësisë së provave dhe në përputhje me standardet e procesit të rregullt gjyqësor.
Së katërti, argumentimi i kontekstit historik dhe juridik të luftës në Kosovë.
Mbrojtja duhet ta argumentojë në mënyrë të dokumentuar kontekstin e luftës së Kosovës, karakterin çlirimtar të saj dhe rrethanat e represionit sistematik të ushtruar nga aparati shtetëror serb kundër popullsisë shqiptare. Duhet të dokumentohet se UÇK-ja u formua në rrethana të represionit, të mohimit të të drejtave themelore dhe të dhunës shtetërore, si organizim i rezistencës dhe i mbrojtjes së popullsisë. Ky kontekst është i domosdoshëm për të kuptuar motivet, qëllimet dhe natyrën e luftës, por nuk duhet të përdoret si zëvendësim i analizës së përgjegjësisë individuale penale.
Karakteri çlirimtar i luftës nuk e përjashton automatikisht përgjegjësinë për ndonjë vepër individuale, nëse ajo provohet sipas ligjit. Ajo që duhet të kundërshtohet me argumente dhe prova është çdo përpjekje për të identifikuar karakterin e organizimit çlirimtar me ekzistencën e një politike apo plani kriminal.
Së pesti, analiza e strukturës organizative dhe komanduese të UÇK-së.
Një nga çështjet më të rëndësishme juridike është mënyra se si është interpretuar organizimi i UÇK-së, struktura e saj komanduese, autoriteti real dhe marrëdhëniet ndërmjet strukturave politike dhe ushtarake. Mbrojtja duhet të ofrojë dokumentacion historik, ushtarak dhe institucional, si dhe dëshmi konkrete për të sqaruar natyrën e organizimit të UÇK-së, shkallën e institucionalizimit të saj, mënyrën e funksionimit të strukturave dhe kufijtë realë të autoritetit të individëve. Nuk mjafton as pohimi i përgjithshëm se nuk ka ekzistuar hierarki komanduese, as supozimi se një pozitë e caktuar nënkupton automatikisht kontroll efektiv mbi çdo pjesëtar apo njësi. Çështja duhet të provohet në mënyrë konkrete dhe të individualizuar, sipas kritereve juridike të përgjegjësisë penale.
Së gjashti, kundërshtimi i pretendimit për ekzistencën e një plani apo qëllimi kriminal.
Mbrojtja duhet të shqyrtojë nëse ka pasur prova konkrete për ekzistencën e ndonjë politike, plani apo ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, nëse janë vërtetuar elementet juridike të saj dhe nëse është provuar lidhja individuale e secilit të akuzuar me veprimet e pretenduara.
Nëse gjatë luftës ka pasur ndonjë veprim kriminal individual nga persona të caktuar, kjo nuk mund të shndërrohet automatikisht në përgjegjësi kolektive të një organizimi të tërë dhe as në përgjegjësi penale të drejtuesve të tij pa provimin e elementeve përkatëse ligjore.

4. Strategji më e fuqishme e provave dhe e dëshmitarëve në përputhje me procedurën ankimore

Një nga mësimet kryesore që duhet nxjerrë nga procesi i shkallës së parë është domosdoshmëria e një strategjie më të gjerë, më konkrete dhe më të diversifikuar të provave. Mbrojtja nuk duhet të mbështetet kryesisht në dëshmitarë të nivelit të lartë politik apo në personalitete të njohura ndërkombëtare, të cilët mund të dëshmojnë për kontekstin historik dhe politik të luftës, por jo domosdoshmërisht për ngjarjet konkrete, vendndodhjet, zinxhirët e komunikimit dhe veprimet individuale. Për këtë arsye, duhet të bëhet një inventar i plotë i dëshmitarëve të mundshëm nga Kosova, përfshirë dëshmitarë okularë, ish-pjesëtarë të UÇK-së, përfaqësues institucionalë, persona që kanë njohuri të drejtpërdrejta për ngjarjet konkrete dhe ekspertë të fushave përkatëse. Mbrojtja duhet të synojë ndërtimin e një baze të fuqishme provuese, e cila do të mundësojë kundërshtimin konkret të pretendimeve të aktakuzës dhe të përfundimeve të aktgjykimit. Megjithatë, duhet të kemi parasysh një dallim thelbësor procedural: ankimi nuk është përsëritje automatike e gjykimit të shkallës së parë dhe as një mundësi e pakufizuar për administrimin e të gjitha provave nga fillimi. Prandaj, ekipet e mbrojtjes duhet të analizojnë me kujdes dispozitat përkatëse të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Rregullave të Procedurës dhe të Provave, për të identifikuar bazat konkrete mbi të cilat mund të kërkohet pranimi i provave shtesë, dëgjimi i dëshmitarëve të rinj ose mbajtja e seancave plotësuese.
Në këtë drejtim, duhet të argumentohen veçanërisht:
* Pse prova e propozuar është relevante dhe materiale për vendimmarrjen.
* Pse ajo nuk është administruar në shkallën e parë, kur kjo është juridikisht e rëndësishme.
* Çfarë ndikimi mund të ketë ajo në konstatimet faktike dhe juridike të aktgjykimit.
* Cilat përfundime të trupit gjykues mund të ndryshojnë nëse prova pranohet.
* Pse dëgjimi i dëshmitarit konkret është i domosdoshëm për sqarimin e një çështjeje vendimtare.
Nëse plotësohen kushtet procedurale, mbrojtja duhet të kërkojë pranimin e provave shtesë, dëgjimin e dëshmitarëve dhe, kur është e nevojshme, mbajtjen e seancave përkatëse. Po ashtu, duhet të shqyrtohet mundësia e kthimit të çështjes në rigjykim, nëse shkeljet e konstatuara dhe dispozitat procedurale e bëjnë këtë mjet juridik të nevojshëm. Qëllimi nuk është thjesht shtimi i numrit të dëshmitarëve. Qëllimi është që çdo dëshmi dhe çdo provë të ketë rëndësi konkrete juridike dhe të kontribuojë në rrëzimin e një pretendimi të caktuar të aktgjykimit.

5. Transparenca dhe monitorimi ndërkombëtar i Dhomave të Specializuara

Një dimension tjetër i rëndësishëm është nevoja për transparencë dhe monitorim të pavarur të respektimit të standardeve ndërkombëtare të gjykimit të drejtë. Republika e Kosovës duhet t'u drejtohet shteteve donatore të Dhomave të Specializuara, duke kërkuar që të mbështesin angazhimin e organizatave prestigjioze

ndërkombëtare për monitorimin e procesit gjyqësor dhe të respektimit të të drejtave të njeriut.
Ky monitorim duhet të përfshijë në veçanti:
* Respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
* Respektimin e prezumimit të pafajësisë.
* Barazinë e armëve ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes.
* Respektimin e së drejtës për mbrojtje efektive.
* Administrimin dhe vlerësimin e paanshëm të provave.
* Respektimin e parimit të gjykimit të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm.
* Transparencën institucionale dhe llogaridhënien për mënyrën e funksionimit të gjykatës.
Në këtë kontekst duhet të merren seriozisht edhe vlerësimet dhe shqetësimet e organizatave profesionale ndërkombëtare, përfshirë Odën e Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit, duke i analizuar rekomandimet dhe gjetjet e tyre konkrete.Monitorimi nuk duhet të jetë ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit dhe as përpjekje për të ndikuar në vendimmarrjen e gjyqtarëve. Ai duhet të shërbejë për të garantuar respektimin e standardeve të gjykimit të drejtë dhe për të rritur besimin në procesin gjyqësor.

6. Angazhimi diplomatik dhe institucional i Republikës së Kosovës

Në këtë fazë kërkohet një angazhim i koordinuar i institucioneve më të larta shtetërore. Presidentja e Republikës së Kosovës, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme duhet të ndërmarrin hapa urgjentë për të komunikuar me shtetet donatore të Dhomave të Specializuara dhe me shtetet mike që kanë mbështetur pavarësinë e Kosovës. Ky komunikim duhet të zhvillohet përmes letrave zyrtare, takimeve diplomatike dhe kontakteve të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e këtyre shteteve. Në këto komunikime duhet të paraqiten shqetësimet legjitime të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës për procesin gjyqësor, për respektimin e standardeve ndërkombëtare dhe për çështjet juridike që dalin nga aktgjykimi i shkallës së parë.
Në veçanti, duhet të kërkohet:
1. Mbështetja për monitorim të pavarur ndërkombëtar të respektimit të të drejtave të njeriut.
2. Transparencë më e madhe për funksionimin e Dhomave të Specializuara.
3. Angazhim i organizatave prestigjioze për vlerësimin e standardeve të gjykimit të drejtë.
4. Mbështetje për ekspertizë juridike ndërkombëtare të pavarur.
5. Respektim i plotë i garancive procedurale dhe i të drejtave të mbrojtjes.
Kosova duhet të veprojë si shtet serioz, me argumente juridike dhe me përgjegjësi institucionale, duke shmangur çdo veprim që mund të interpretohet si presion politik mbi gjykatën.

7. Mësimi nga përvoja kroate: analiza juridike e rastit Gotovina dhe Markač

Në përgatitjen e strategjisë së re duhet të analizohet në mënyrë të veçantë përvoja e Kroacisë në proceset gjyqësore që lidhen me luftën e saj dhe me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Veçanërisht i rëndësishëm është rasti i gjeneralëve kroatë Ante Gotovina dhe Mladen Markač, të cilët në shkallën e parë ishin dënuar, ndërsa më 16 nëntor 2012, Dhoma e Apelit e Tribunalit i liroi nga akuzat përkatëse dhe rrëzoi dënimet e shkallës së parë. Ky rast duhet të studiohet jo vetëm si përvojë historike dhe politike, por para së gjithash si precedent i rëndësishëm për analizën e standardeve të vlerësimit të provave dhe të përgjegjësisë penale.

Në veçanti, ekspertët kosovarë duhet të analizojnë:
1. Si u sfiduan konstatimet faktike të shkallës së parë.
2. Si u trajtuan provat mbi të cilat ishte mbështetur përfundimi për ekzistencën e një plani të përbashkët kriminal.
3.Çfarë rëndësie mori standardi i vlerësimit të provave në shkallën e apelit.
4. Si u analizua lidhja ndërmjet veprimeve individuale dhe përgjegjësisë penale.
5. Cilat ishin arsyet juridike që çuan në rrëzimin e dënimeve.
6. Çfarë mund të nxirret nga kjo përvojë për strategjinë ankimore në rastin e krerëve të UÇK-së.
Ky studim duhet të jetë konkret dhe i mbështetur në tekstin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe në aktgjykimin e apelit të Tribunalit, jo në interpretime të përgjithshme politike. Përvoja kroate nuk duhet të kopjohet mekanikisht, sepse secili proces ka specifikat e veta faktike dhe juridike. Megjithatë, ajo dëshmon se një analizë e thellë profesionale e provave dhe e arsyetimit gjyqësor mund të ketë rëndësi vendimtare në procesin ankimor. Mësimi kryesor është se një mbrojtje e fuqishme nuk ndërtohet vetëm me deklarata politike dhe argumente historike, por me ekspertizë të thellë juridike, dokumentacion të besueshëm dhe kundërshtim sistematik të çdo prove dhe konstatimi të kontestueshëm.

8. Kosova nuk ka kohë për të humbur

Procesi ankimor në Dhomat e Specializuara kërkon një qasje të re, urgjente dhe të organizuar. Kjo nuk është koha për përplasje partiake, deklarata të zakonshme politike apo iniciativa që nuk prodhojnë rezultate konkrete. Kjo është koha për ekspertizë juridike, për mobilizim të kapaciteteve më të mira profesionale të Kosovës dhe për një angazhim të koordinuar institucional. Republika e Kosovës duhet ta kuptojë se mbrojtja e krerëve të UÇK-së në këtë fazë nuk mund të mbetet vetëm përgjegjësi e ekipeve individuale të avokatëve. Shteti duhet të krijojë kushtet për ofrimin e ekspertizës vendore, dokumentacionit historik dhe institucional dhe analizave juridike që mund t'i ndihmojnë ekipet e mbrojtjes, pa cenuar autonominë e tyre profesionale dhe pavarësinë e gjykatës.
Në këtë drejtim, propozoj që menjëherë të ndërmerren këto veprime:
1. Të themelohet komisioni shtetëror i ekspertëve juridikë.
2. Të përgatitet brenda muajit nëntor një dokument gjithëpërfshirës për shkeljet e mundshme materiale dhe procedurale të evidentuara në procesin e shkallës së parë.
3. Të vihet ky dokument në dispozicion të ekipeve të mbrojtjes si ekspertizë plotësuese juridike.
4. Të identifikohen dëshmitarët dhe provat shtesë që mund të pranohen sipas rregullave të procedurës ankimore.
5. Të angazhohen ekspertë ndërkombëtarë për analizën e çështjeve më komplekse juridike.
6. Të kërkohet monitorim i pavarur ndërkombëtar për respektimin e standardeve të gjykimit të drejtë.
7. Të aktivizohet diplomacia kosovare në raport me shtetet donatore dhe shtetet mike të Kosovës.
8. Të studiohet në mënyrë të specializuar përvoja e rastit Gotovina dhe Markač, me qëllim të identifikimit të argumenteve dhe standardeve juridike që mund të jenë relevante për procesin aktual.
Një çështje duhet të jetë e qartë: puna e komisionit shtetëror nuk duhet të presë dhe as të vonojë punën e ekipeve të mbrojtjes. Të dy proceset duhet të zhvillohen paralelisht, sepse respektimi i afateve procedurale është kusht themelor për efektivitetin e çdo strategjie ankimore.
Duhet të jemi të vetëdijshëm se kemi përpara një betejë të vështirë, komplekse dhe me pasoja të mëdha juridike, historike dhe shtetërore. Për këtë arsye kërkohen seriozitet, profesionalizëm, unitet institucional dhe vendosmëri. Lufta e UÇK-së duhet të mbrohet përmes së vërtetës historike, ndërsa pafajësia e të akuzuarve duhet të argumentohet përmes provave dhe standardeve të së drejtës penale.
Tani nuk është koha për një betejë politike. Është koha për një betejë juridike, të organizuar, ofensive dhe profesionale. Kosova duhet të veprojë menjëherë, sepse çdo ditë e humbur mund të jetë një mundësi e humbur për ndërtimin e një mbrojtjeje më të fuqishme. Nuk kemi kohë për të humbur. Tani është koha për veprim shtetëror, profesional dhe juridik.

Akademik Arsim Bajrami
Prishtinë, 9 nëntor 2026


Mike Corder (AP)

PLANI AMERIKAN PËR SIGURINË E EVROPËS: ÇFARË MUND TË NDRYSHOJË PËR KOSOVËN?

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Prania e NATO-s në Kosovë nuk pritet të ndikohet drejtpërdrejt nga ndryshimet e mundshme në sigurinë evropiane. Perspektiva e Kosovës për anëtarësim në Aleancë dhe marrëdhëniet e saj të sigurisë me Shtetet e Bashkuara, megjithatë, mund të përballen me sfida të reja.

Kështu vlerëson ish-zyrtari i lartë i NATO-s, Jamie Shea, për Radion Evropa e Lirë, në kohën kur Uashingtoni ka propozuar një kornizë më të gjerë për sigurinë e Evropës, krahas përpjekjeve për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë.

Sipas tij, dy çështje mund të kenë rëndësi të veçantë për Kosovën: përpjekjet e Rusisë për ta penguar zgjerimin e NATO-s dhe ato për ta kufizuar praninë ushtarake amerikane në Evropë.

Propozimi amerikan, i paraqitur më 5 nëntor nga Jared Kushner, i dërguari i presidentit Donald Trump, synon të forcojë konsultimet për sigurinë, komunikimin në raste krizash dhe transparencën ushtarake, si dhe të krijojë mekanizma për uljen e rrezikut të përshkallëzimit të tensioneve.

Nisma vjen në prag të bisedimeve të planifikuara ndërmjet ShBA-së, Ukrainës dhe Rusisë, më 10 dhe 11 nëntor, në Abu Dabi.

Trumpi ka lënë të kuptohet se përpjekjet diplomatike mund t'i hapin rrugë një marrëveshjeje që shtrihet përtej Ukrainës dhe përfshin sigurinë e Evropës.

Kushner, ndërkaq, ka theksuar se NATO-ja duhet të mbetet në qendër të mbrojtjes kolektive evropiane dhe se asnjë shtet nuk duhet të ketë të drejtë vetoje mbi zgjedhjet e sigurisë apo aleancat e një vendi tjetër.

Ende nuk dihet se çfarë do të përfshinte një marrëveshje e tillë, ndërsa nuk ka informacione publike se Kosova dhe KFOR-i janë pjesë e diskutimeve.



Pse KFOR-i nuk pritet të ndikohet?

Për Shean, KFOR-i nuk pritet të preket nga ndryshimet e mundshme në sigurinë evropiane, për shkak të mandatit dhe natyrës së tij paqeruajtëse. "Nuk do të mendoja se po", thotë ai, i pyetur nëse këto ndryshime mund të kenë pasoja për misionin e NATO-s në Kosovë.

KFOR-i vepron në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të miratuar në vitin 1999 edhe me votën e Rusisë. "Moska e vlerëson faktin që KFOR-i është atje kryesisht për të mbrojtur komunitetin serb të Kosovës", thotë Shea për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, Rusia synon të kufizojë praninë e forcave të NATO-s me armatim të rëndë në Evropën Qendrore dhe Lindore, ndërsa KFOR-i, si mision paqeruajtës, nuk bën pjesë në këtë kategori.

I vendosur në Kosovë pas përfundimit të luftës, KFOR-i ka për detyrë të kontribuojë në ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të lirisë së lëvizjes për të gjitha komunitetet.

Misioni numëron rreth 4 700 ushtarë, pas përforcimit të pranisë në vitin 2023, si pasojë e tensioneve në veri të Kosovës.

Përmirësimi i situatës së sigurisë, sipas vlerësimit të NATO-s, ka hapur rrugën për një përshtatje graduale të numrit të trupave.

Në qershor të këtij viti, Aleanca paralajmëroi synimin për t'iu kthyer niveleve të mëparshme, në varësi të kushteve në terren.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka përmendur si objektiv një prani prej rreth 3 000 deri në 3 500 ushtarësh.

NATO-ja ka theksuar se procesi është i kthyeshëm dhe e ka lidhur atë me vlerësimin e situatës së sigurisë në Kosovë.

Nëse Kosova apo KFOR-i janë përfshirë në diskutimet e fundit për sigurinë evropiane, mbetet e paqartë.

E pyetur nga Radio Evropa e Lirë, NATO-ja nuk dha përgjigje të drejtpërdrejtë për këtë çështje.

Zëdhënësja Allison Hart konfirmoi se përfaqësues të NATO-s, ShBA-së, Ukrainës, vendeve evropiane dhe Bashkimit Evropian u takuan më 5 nëntor në Bruksel, në kuadër të përpjekjeve për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë.

E pyetur sërish nëse Kosova ose KFOR-i ishin pjesë e diskutimeve, NATO-ja tha se nuk ka informacione të tjera për të ndarë.

A mund të pengohet anëtarësimi i Kosovës në NATO?

Nëse KFOR-i nuk pritet të preket drejtpërdrejt, zgjerimi i NATO-s është një çështje ku Shea sheh pasoja të mundshme për Kosovën.

Rusia e kundërshton prej kohësh zgjerimin e Aleancës.

Në dhjetor të vitit 2021, para pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës, Moska kërkoi garanci që NATO-ja të mos pranonte anëtarë të rinj dhe të kufizonte praninë e saj ushtarake në Evropën Lindore.

Kërkesa e Moskës për kufizimin e pranisë ushtarake të NATO-s në nivelet e para vitit 1997 është rikthyer në vëmendje, mes raportimeve se Rusia mund ta shtrojë sërish gjatë negociatave për sigurinë evropiane.

Sipas Sheas, Rusia do të përpiqet të pengojë zgjerimin e mëtejshëm të NATO-s, me Ukrainën si shqetësimin kryesor.

Një kufizim i tillë, thotë ai, do të kishte pasoja edhe për aspiratat e Kosovës. "Kjo do t'i pengonte mundësitë e Kosovës për t'u anëtarësuar një ditë në NATO", thotë Shea.

Rruga e Kosovës drejt Aleancës, sidoqoftë, është e ndërlikuar edhe pa kërkesat ruse.

Katër vende anëtare - Spanja, Greqia, Rumania dhe Sllovakia - nuk e njohin pavarësinë e saj, ndërsa pranimi i anëtarëve të rinj kërkon konsensusin e të gjithë aleatëve.

NATO-ja vazhdon të mbështesë politikën e dyerve të hapura. Edhe propozimi amerikan thekson se asnjë shtet nuk duhet të ketë të drejtë vetoje mbi zgjedhjet e sigurisë apo aleancat e një vendi tjetër.

Kështu, ndalimi i zgjerimit të NATO-s mbetet kërkesë e Moskës, jo pjesë e qëndrimit të shpallur amerikan.

Përveç anëtarësimeve të reja, Shea vlerëson se Rusia mund të përpiqet të pengojë edhe vendosjen e forcave shtesë të NATO-s në Ballkanin Perëndimor.

Sipas tij, Moska mund të shqetësohet veçanërisht nëse ndryshimet politike në Serbi e afrojnë Beogradin me Aleancën.

Megjithatë, thekson se Ballkani Perëndimor nuk është ndër përparësitë kryesore ushtarake të Rusisë.

Vëmendja e Moskës, sipas tij, është e përqendruar më shumë në rajonin e Detit të Zi, Poloni, shtetet baltike dhe veriun e Evropës - zona më pranë kufijve rusë.

Çfarë mund të ndryshojë në angazhimin amerikan?

Përtej zgjerimit të NATO-s, një tjetër çështje me rëndësi për Kosovën është e ardhmja e pranisë ushtarake amerikane në Evropë.

Shea kujton se Rusia ka kërkuar edhe më herët tërheqjen e forcave amerikane nga kontinenti. "Një masë e tillë mund të ndikojë në Kosovë, e cila ka kultivuar gjithmonë marrëdhënie të ngushta të sigurisë me ShBA-në", thotë ai.

Uashingtoni tashmë po rishikon angazhimet ushtarake në Evropë, duke kërkuar që aleatët evropianë të marrin më shumë përgjegjësi për mbrojtjen e kontinentit.

Në Kosovë, prania amerikane është zvogëluar gradualisht që nga përfundimi i luftës, më 1999. Nga mijëra ushtarë në vitet e para të misionit, kontingjenti amerikan në KFOR numëron sot rreth 600 pjesëtarë.

Në qershor, Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara (EUCOM) konfirmoi për REL-in se do ta përshtaste kontributin amerikan në KFOR në faza, në përputhje me planet e NATO-s dhe vlerësimet e sigurisë.

Ajo theksoi se ShBA-ja vazhdon ta konsiderojë KFOR-in një komponent kyç të stabilitetit rajonal, pa dhënë hollësi për përmasën e ndryshimeve.

Një tjetër zhvillim u shënua më 12 tetor, kur Garda Kombëtare e Floridës ua dorëzoi komandën e KFOR-it për Rajonin Lindor njësive aktive të Ushtrisë amerikane, në kampin Bondsteel.

Ky ndryshim, i pari i këtij lloji pas më shumë se një dekade, përbën riorganizim të njësive dhe nuk është shoqëruar me njoftim për tërheqje nga Kosova.

Nëse rishikimi më i gjerë i angazhimeve amerikane në Evropë do të ndikojë në të ardhmen e pranisë së tyre në Kosovë, mbetet e paqartë.

Radio Evropa e Lirë pyeti Pentagonin nëse propozimi për sigurinë evropiane mund të ketë pasoja për KFOR-in, trupat amerikane në Kosovë apo angazhimet e Uashingtonit në Ballkanin Perëndimor.

Pentagoni e udhëzoi REL-in t'i drejtohej Shtëpisë së Bardhë, e cila nuk iu përgjigj kërkesës për koment deri në përgatitjen e këtij artikulli.

Sipas Sheas, zvogëlimi i pranisë ushtarake amerikane në Evropë ka nisur pavarësisht negociatave me Rusinë. Ai vlerëson se përbërja e re e Kongresit amerikan mund t'ia vështirësojë administratës Trump reduktimin e mëtejshëm të forcave.

Kosova përballë një roli më të madh të Evropës

Ndërsa Uashingtoni shqyrton një kornizë më të gjerë të sigurisë, vendet evropiane kërkojnë të kenë rol në vendimet që prekin të ardhmen e kontinentit.

Shefja e diplomacisë së Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, ka theksuar se Evropa tashmë ka një arkitekturë të sigurisë, por se Rusia vazhdon t'i shkelë marrëveshjet mbi të cilat ajo mbështetet.

Kallas ka deklaruar se presidenti rus, Vladimir Putin, nuk ka të drejtë vetoje mbi sigurinë evropiane dhe se BE-ja duhet të përfshihet në negociatat për çdo marrëveshje paqeje për Ukrainën.

Kërkesa për përfshirje u përforcua më 8 nëntor, kur ministri i Jashtëm francez, Jean-Noel Barrot, konfirmoi se përfaqësues evropianë do të marrin pjesë në diskutimet e planifikuara në Abu Dabi.

Propozimi amerikan, ndërkohë, mbetet në fazën e diskutimeve dhe nuk ka ndonjë marrëveshje për ndryshimin e arkitekturës së sigurisë evropiane.

Shea thotë se Kosova duhet të përgatitet për një rol më të madh të vendeve evropiane në sigurinë e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht rezultatit të negociatave aktuale.

Sipas tij, evropianët tashmë kanë marrë pjesën më të madhe të përgjegjësisë për sigurinë e rajonit, ndërsa Kosova duhet t'i forcojë marrëdhëniet me ta dhe me Bashkimin Evropian, në vend që të mbështetet së tepërmi tek Uashingtoni.

Për Shean, kjo nevojë shkon përtej negociatave me Rusinë dhe lidhet me ndryshimet afatgjata në rolin ushtarak të Shteteve të Bashkuara në Evropë.

GREVA PËR PAGA LË KOSOVËN PA TRANSPORT HEKURUDHOR



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Qarkullimi i trenave të udhëtarëve në Kosovë është ndërprerë më 9 nëntor për shkak të grevës së punëtorëve të ndërmarrjes publike "Infrakos", të cilët kërkojnë rritjen e pagave në përputhje me pozitat dhe përgjegjësitë e tyre.

Ndërprerja ka prekur linjën Prishtinë - Pejë, e vetmja që aktualisht funksionon për transportin e udhëtarëve në vend.

Sipas njoftimit të ndërmarrjes publike "Trainkos", treni i paraparë të nisej nga Prishtina në orën 07:50 do ta ndërpriste udhëtimin në Fushë-Kosovë, pasi "Infrakos" kishte paralajmëruar ndalimin e shërbimeve infrastrukturore nga ora 08:00.

Pezullimi i shërbimeve ka pamundësuar edhe qarkullimet e tjera deri në normalizimin e situatës.

"Trainkos", që është përgjegjës për transportin hekurudhor, tha se ndërprerja ka ndodhur për shkaqe jashtë mundësive të tij operative dhe se shërbimet do të rikthehen sapo të krijohen kushtet.

Pse protestojnë punëtorët?

Hysen Nikqi, nga Këshilli Grevist i "Infrakos"-it, tha për Radion Evropa e Lirë se kërkesa kryesore e punëtorëve është indeksimi i pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarve. Sipas tij, pakënaqësitë janë shtuar pas rritjes së pagës minimale në 500 euro, nga korriku i këtij viti, pasi pagat e punëtorëve të tjerë nuk janë rritur në mënyrë proporcionale. Kjo, sipas Nikqit, ka bërë që dallimet në paga ndërmjet punonjësve me kualifikime dhe përgjegjësi të ndryshme të ngushtohen ndjeshëm. "Me vendim të Qeverisë, tashmë paga minimale ka arritur në 500 euro dhe ka prekur një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Por, pjesa tjetër është ngushtuar, sepse pagat nuk janë rritur në mënyrë proporcionale për të gjitha kategoritë", tha Nikqi. Ai përmendi si shembull dallimin e vogël në paga ndërmjet inxhinierëve dhe punëtorëve teknikë apo shërbyes, duke thënë se struktura aktuale e pagave nuk pasqyron përgjegjësitë e secilës pozitë.

Sipas tij, "Infrakos"-i ka rreth 200 punëtorë.

Nikqi nuk dha të dhëna për pagën mesatare në ndërmarrje, ndërsa paralajmëroi se greva do të vazhdojë edhe në ditët në vijim, deri në përmbushjen e kërkesave të punëtorëve.

Radio Evropa e Lirë i është drejtuar edhe menaxhmentit të "Infrakos"-it me pyetje lidhur me pagën mesatare të punonjësve dhe hapat e mundshëm për zgjidhjen e situatës, por deri në publikimin e këtij lajmi nuk ka marrë përgjigje.

"Infrakos" dhe "Trainkos" janë dy ndërmarrje publike me përgjegjësi të ndryshme.

E para menaxhon infrastrukturën hekurudhore, përfshirë binarët dhe sistemet e nevojshme për qarkullimin e trenave, ndërsa e dyta ofron shërbimet e transportit.

Për këtë arsye, "Trainkos" varet nga shërbimet infrastrukturore të "Infrakos"-it për të operuar trenat, edhe kur vetë ndërmarrja e transportit nuk është pjesë e grevës.

Greva e paralajmëruar dy javë më parë

Ndërprerja e qarkullimit të trenave vjen pas një proteste që punëtorët e "Infrakos"-it mbajtën më 26 tetor, para stacionit hekurudhor në Fushë Kosovë. Atëherë ata paralajmëruan se do të hynin në grevë nëse kërkesat e tyre nuk do të adresoheshin nga drejtuesit e ndërmarrjes.

Përveç indeksimit të pagave, punëtorët kërkuan përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e sigurisë.

Përfaqësuesit sindikalë kritikuan bordin dhe menaxhmentin e ndërmarrjes, duke pretenduar se nuk kishin ndërmarrë hapa konkretë për plotësimin e kërkesave të tyre.

Në deklarimet publike të 9 nëntorit, përfaqësuesit e sindikatës përmendën edhe kërkesën për rritjen e kompensimit për ushqim dhe pagesa retroaktive për tre muajt e fundit.

Si ndikoi rritja e pagës minimale?

Paga minimale në Kosovë ka shënuar rritje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Nga 350 euro bruto në vitin 2024, ajo u rrit në 425 euro në janar të vitit 2026 dhe në 500 euro nga korriku, sipas vendimit të Qeverisë, të marrë më 31 tetor 2025.

Kjo përbën një rritje prej rreth 43 për qind krahasuar me nivelin e vitit 2024.

Megjithatë, rritja e pagës minimale nuk nënkupton automatikisht rritje proporcionale për punonjësit që paguhen mbi këtë nivel.

Pikërisht kjo është në qendër të pakënaqësive në "Infrakos", ku përfaqësuesit sindikalë kërkojnë që pagat të pasqyrojnë kualifikimet, pozitat dhe përgjegjësitë e punëtorëve.

Transporti hekurudhor, me vetëm një linjë aktive

Greva e gjen transportin hekurudhor të udhëtarëve në Kosovë me shërbime të kufizuara. Aktualisht, linja Prishtinë-Pejë dhe anasjelltas është e vetmja që funksionon për udhëtarët, me nga dy udhëtime në ditë në secilin drejtim.

Sipas të dhënave të "Trainkos"-it, gjatë vitit të kaluar mbi 88 mijë udhëtarë shfrytëzuan transportin hekurudhor - rreth 20 për qind më shumë se në vitin 2024.

Ndërprerja e shërbimeve nga "Infrakos" nënkupton kështu pezullimin e të gjithë transportit të rregullt hekurudhor të udhëtarëve në vend.

Hekurudhat e Kosovës, mes investimeve dhe vonesave

Ndërprerja e qarkullimit të trenave vjen në një kohë kur sektori hekurudhor i Kosovës vazhdon të përballet me probleme infrastrukturore dhe vonesa në realizimin e investimeve.

Një nga projektet më të mëdha është rehabilitimi i Linjës 10, që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut në jug dhe Serbinë në veri, me synimin për të përmirësuar transportin dhe lidhjet hekurudhore rajonale.

Megjithëse punimet kanë nisur prej vitesh, projekti ende nuk ka përfunduar.

Në raportin e publikuar më 4 nëntor, Komisioni Evropian vlerësoi se përparimi në rehabilitimin e Linjës 10 mbetet i kufizuar.

Sipas Komisionit, punimet në dy fazat e para, që përfshijnë segmentet Hani i Elezit – Fushë-Kosovë dhe Fushë-Kosovë - Mitrovicë, kanë vazhduar me ritëm të ngadalshëm, duke u përqendruar kryesisht në ndërhyrje teknikisht të ndërlikuara në ura dhe tunele.

Raporti evidenton edhe vonesa në tenderimin e sistemeve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit, të nevojshme për të mundësuar qarkullimin e trenave me shpejtësi mbi 100 kilometra në orë.

Edhe pse infrastruktura e kalimit hekurudhor me Maqedoninë e Veriut ka përfunduar, operimet e përbashkëta ende nuk kanë filluar.

Komisioni Evropian kërkoi nga Kosova t'i përshpejtojë punimet dhe t'i adresojë problemet teknike, administrative dhe institucionale që pengojnë përfundimin e projektit.

Qeveria e Kosovës u zotua se do t'i marrë seriozisht të gjitha rekomandimet e Komisionit Evropian dhe se do të angazhohet për adresimin e tyre.

Deri në 100 MW kapacitete të reja nga era: hapen ofertat financiare të ankandit të parë

Prishtinë, 9 nëntor - Ministria e Ekonomisë ka mbajtur të hënën ceremoninë e hapjes publike të ofertave financiare, në kuadër të ankandit të parë konkurrues për energjinë e erës në Kosovë, me kapacitet të synuar deri në 100 megavate.

Në këtë proces konkurrues, kompania "Akuo Energy SAS" ka paraqitur ofertën me çmimin më të ulët, duke u pozicionuar si ofertuesi më i favorshëm financiarisht për zhvillimin e këtij projekti.

Hapja publike e ofertave financiare vjen pas përfundimit të fazës së vlerësimit teknik. Më 10 shtator 2026 ofertat i kishin dorëzuar tre ofertues: 1. Konsorciumi "Notus Energy GmbH" dhe "Stublla Energy LLC", nga Gjermania dhe Kosova; 2. "Akuo Energy SAS", nga Franca; dhe 3. "GÜRİŞ İnşaat ve Mühendislik AS", nga Turqia.

Pas vlerësimit të ofertave dhe verifikimit të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në dokumentacionin e ankandit, dy ofertues kanë kaluar në fazën e vlerësimit financiar.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, theksoi se procesi është udhëhequr me përkushtim ndaj transparencës, konkurrencës së drejtë dhe mbrojtjes së interesit publik, me synim sigurimin e energjisë me çmimin më të favorshëm për qytetarët e Kosovës.

Ajo theksoi se përzgjedhja e ofertuesit më të favorshëm financiarisht, pas përmbushjes së kritereve teknike dhe ligjore, është mënyra më e mirë për të garantuar realizimin e investimit dhe mbrojtjen e interesit publik.

Ministrja Rizvanolli potencoi gjithashtu rëndësinë e energjisë së erës në diversifikimin e burimeve të prodhimit dhe forcimin e sigurisë energjetike të vendit.



Shkruan: Naim KRASNIQI, *fizikan*

PROVA TË REJA KONFIRMUESE PËR FUSHËN ANTIMAGNETIKE

Naim Krasniqi, me angazhimin e tij shkencor dhe eksperimentues, vazhdon të sjellë risi në disiplinën e fizikës, posaçërisht në nëndisiplinën e magnetizmit. Ai sjellë risi të tjera, përmes të cilave, edhe në një mënyrë tjetër, konfirmon krijimin e fushës antimagnetike në kushte eksperimentale. Forca shtytëse njihet nga fizika, porse shkencëtari Naim Krasniqi e ka konkretizuar atë dhe e ka shndërruar në një forcë me përmasa tejet relevante

Hyrje

Duke qenë se fusha antimagnetike është një fenomen i ri për shkencën e fizikës, dhe i intriguar vazhdimisht prej saj, kam vazhduar kërkimin për të gjetur prova të tjera eksperimentale por edhe për të sjellë dëshmi për ekzistencën e kësaj fushe të re. Qasja që kam përdorur është metoda eksperimentale.

Përmbledhje e rezultatit eksperimental

Në kushtet eksperimentale është demonstruar se polet magnetike ristrukturohen në dipole eksterne dhe dipole interne magnetike brenda të njëjtit magnet. Formimi i dipolit antimagnetik (daM') në brendësi të dipolit magnetik (DM'), e transformon dipolin magnetik (DM'), në një trup magnetik që përbëhet nga *dy pole eksterne magnetike* të veriut dhe jugut [(eN), (eS)], si dhe *dy pole interne antimagnetike* të veriut dhe jugut [(iaN'), (iaS')].
Po ashtu, demonstrohet formimi i fushës antimagnetike në brendësi të fushës magnetike brenda vrimës së diskut magnetik. Dy fushat magnetike eksterne [f(eN), f(eS)] që burojnë nga polet eksterne magnetike [(eN), (eS)] veprojnë me forca tërheqëse [(Fe_1), (Fe_2)] ndaj poleve magnetike [('N), ('S)] të sferës së magnetizuar, kurse dy fushat antimagnetike interne [f(iaN'), f(iaS')] që burojnë nga polet interne antimagnetike [(iaN'), (iaS')] veprojnë njëkohësishtë me forca shtytëse [(fi_1'), (fi_2')] ndaj të njëjtave pole magnetike të veriut dhe jugut [('N), ('S)], të të njëjtës sferë të magnetizuar.
Eksperimenti vërteton se fusha antimagnetike vepron gjithmonë kundër fushës magnetike.

Metodologjia

Bazat teorike


Fusha antimagnetike që krijohet brenda fushës magnetike është po ashtu një fushë magnetike, por, për shkak se ka polaritet të kundërt, është emërtuar fushë antimagnetike.

Mënyra se si arrihet të bëhet dallimi ndërmjet fushës antimagnetike dhe një fushe magnetike, të cilat kanë polaritete të njëjta magnetike, bazohet në parimin e funksionimit të termometrit. Përderisa sot nuk ekziston asnjë termometër që e dallon origjinën e energjisë termike, pra nëse temperatura vjen nga një pllakë e kuzhinës apo nga një stufë me dru, termometri e paraqet atë thjesht si një temperaturë të shprehur në gradë Celsius. Megjithatë, ne kemi mundësi ta detektojmë origjinën e asaj temperature që shfaqet në termometër.
Në të njëjtën mënyrë, sot nuk ekziston asnjë magnetometër që e dallon origjinën e një fushe magnetike nga një fushë tjetër magnetike me polaritet të njëjtë magnetik, qoftë veri–veri [(N), (N)] apo jug–jug [(S), (S)].
Ky proces mund të shpjegohet përmes një shembulli: nëse një magnetometër vendoset ndërmjet dy poleve magnetike të njëjta, për shembull, njërit pol të një magnetiti natyror të magnetizuar dhe njërit pol të një magneti artificial të fuqishëm (NdFeB), magnetometri i detekton ato si pole magnetike me polaritet të njëjtë magnetik, qofshin veri–veri [(N), (N)] apo jug–jug [(S), (S)], por nuk e dallon origjinën e secilit pol magnetik, pra se nga cili magnet vjen.
Megjithatë, pavarësisht se magnetometri nuk e dallon origjinën e një poli magnetik nga një pol tjetër me polaritet të njëjtë magnetik, ne, përmes forcës së veprimit, mund ta dallojmë origjinën e asaj fushe magnetike.
Prandaj, edhe kur kemi të bëjmë me fusha magnetike dhe antimagnetike që kanë polaritete të njëjta magnetike veri-veri, [(N), (N)] apo jug-jug [(S), (S)], vetëm përmes forcës së veprimit, mund të vërtetojmë me saktësi se brenda një fushe magnetike formohet një fushë magnetike e kundërt, e ajo është fusha antimagnetike.
Në eksperimentet e mëhershme, që i kam përmbledhë në librin "Fusha antimagnetike në makrobotë" është demonstruar se kur mbi polet magnetike të një magneti permanent të një disku magnetik (dM') vendosen pllakat feromagnetike (1A') dhe (2A'), nga pjesa anësore e diskut magnetik buron dhunshëm fusha antimagnetike.
Se cila është natyra dhe si krijohet fusha antimagnetike në brendësi të fushës magnetike të diskut magnetik, nuk e kam shpjeguar pasi që fokusi ishte te demonstrimi i ekzistencës së fushës antimagnetike. Duke i vazhduar eksperimentet, kam arritur në një provë dhe shpjegim të ri, që vetëm sa e konfirmojnë zbulimin e asaj fushe në kushte eksperimentale. Në vazhdim do t'i paraqes disa nga rezultatet e eksperimenteve, që paraqesin një risi të lidhur me fushën e induktuar magnetike, risi kjo e cila si fenomen është i njohur nga fizika, porse këtu shkohet më larg duke treguar rolin e saj që nuk ishte njohur më parë dhe ende nuk njihet.

1. Formimi i fushës së induktuar magnetike të jugut f(IS') në brendësi të polit magnetik të veriut (N) të diskut magnetik


Para se të vendosen pllakat feromagnetike mbi polet magnetike të diskut magnetik kemi këto vlera:

1) Në pikën (p_1) të polit magnetik të jugut (S) kemi një vlerë të fushës magnetike të jugut $B_S \approx 125mT$,
2) Në pikën (p_{10-11}) në mes të poleve magnetike kemi vlera ekuivalente të fushës magnetike të veriut dhe jugut $B_S \approx B_N \approx 0mT$, kurse
3) Në pikën (p_{20}) të polit magnetik të veriut (N) kemi një vlerë të fushës magnetike ($B_N \approx 125mT$).




Në eksperimentet e kryera, në momentin kur vendoset pllaka feromagnetike (1A') mbi polin magnetik të veriut (N) të diskut magnetik, vërtetohet saktë përmes magnetometrit se pllaka e magnetizuar (1A') e indukon fushën e saj magnetike të jugut f(IS') në brendësi të polit magnetik të veriut (N) të diskut magnetik,
Induktimin e fushës magnetike të jugut (S') nga pllaka e magnetizuar (1A') në brendësi të diskut magnetik bëhet në mesin e diskut magnetik në mes ty fushave magnetike nga pika (p_{10-11}) deri në pikën (p_{13-14}).
Krahas induktimit të fushës magnetike të jugut brenda polit magnetik të veriut (N) magnetometri tregon po ashtu:

a) një rritje të vlerës së fushës magnetike të jugut në pikën (p_1) nga vlera $B_S \approx 125mT$ në vlerën $B_S \approx 135mT$, si dhe
b) një zbritje të vlerës së fushës magnetike të veriut në pikën (p_{20}) nga vlera $B_N \approx 125mT$ në vlerën $B_N \approx 69mT$.



Me ngjyrë të kuqe dhe simbole (N), nga pika (p_{13-14}) deri te pika (p_{20}) kemi fushë magnetike të veriut f(N) që është tkurrur për vlerën e 30% nga vlera e përgjithshme e polaritetit magnetik verior.
Me ngjyrë të verdhë dhe simbole (IS') , nga pika (p_{10-11}) deri në pikën (p_{13-14}) kemi prezencën e fushës së induktuar magnetike të jugut f(IS'), që tërhiqet nga fusha magnetike e veriut f(N), dhe frenohet nga fusha magnetike e jugut f(S), dhe përqendrohet në mes të këtyre dy fushave në brendësi të diskut magnetik.
Kurse me ngjyrë të kaltër dhe simbol (S), nga pika (p_1) deri në pikën (p_9) kemi fushën magnetike të jugut f(S) e cila për shkak të presionit të fushës së indukur magnetike të jugut f(IS') tkurret pak në drejtim të pikës (p_1) të polit magnetik të jugut (S). Këtë tkurrje e vërteton

magnetometri për shkak të ngritjes së fushës magnetike të jugut në pikën (p_1).
Koncentrimi i fushës së induktuar magnetike të jugut f(IS') në brendësi të polit magnetik të veriut (N) , e formon polin e induktuar magnetik të jugut (IS') në brendësi të polit magnetike të veriut (N) të diskut magnetik.



(1A')....Pllaka feromagnetike e magnetizuar
f(S')....Fusha magnetike e jugut që indukohet nga pllaka e magnetizuar (1A') në brendësi të polit magnetik të veriut (N) të diskut magnetik
(S).....Poli magnetik i jugut i diskut magnetik
(IS')....Poli i indukuar magnetik i jugut
(N).....Poli magnetik i veriut i diskut magnetik
(dM')....Disku magnetik
[('S), ('N)]...Polet magnetike të sferës së magnetizuar
(→)..... Shigjeta me të ngjyrë të kaltër tregon kalimin e fushës magnetike të jugut f(S') nga pllaka e magnetizuar (1A') në brendësi të polit magnetik të veriut (N) të diskut magnetik (dM')


Poli magnetik i veriut (N) transformohet në një dipol të induktuar magnetik

Formimi i polit të induktuar magnetik të jugut (IS') në brendësi të polit magnetik të veriut (N), e transformon polin magnetik të veriut (N) në një dipol të induktuar magnetik të veriut *(dIN')* i cili përbëhet nga:


1) poli magnetik i veriut (N), nga i cili pol buron fusha magnetike e veriut f(N), e cila vepron me forcë tërheqëse (F_1) ndaj polit magnetik të jugut ('S) të sferës së magnetizuar, si dhe

2) poli i induktuar magnetik i jugut (IS'), nga i cili pol buron fusha e induktuar magnetike e jugut f(IS'), e cila vepron me forcë shtytëse (f_1') ndaj të të njëjtit pol magnetik të jugut ('S) të të njëjtës sferë të magnetizuar.

Pasi fusha e induktuar magnetike e jugut f(IS'), që formohet brenda polit magnetik të veriut (N) të diskut magnetik, e kundërshton me forcë shtytëse (f_1') forcën tërheqëse (F_1) të fushës magnetike të veriut f(N) ndaj polit magnetik të jugut ('S) të sferës së magnetizuar, për këtë arsye, është fushë antimagnetike e jugut f(aS'), kurse poli induktuar magnetik i jugut (IS') është pol antimagnetik i jugut (aS).




(F_1)...Forca tërheqëse në mes të fushës magnetike të veriut f(N) të diskut magnetik (dM') me fushën magnetike të jugut f('S) të sferës së magnetizuar,
(f_1')...Forca shtytëse në mes fushës së indukuar magnetike të jugut f(aS') me fushën magnetike të jugut f('S) të sferës së magnetizuar,
(F_1)...Forca tërheqëse në mes fushës magnetike të jugut f(S) të diskut magnetik (dM') me fushën magnetike të jugut f('S) të sferës së magnetizuar.
Fusha antimagnetike e jugut f(aS'), që buron nga poli antimagnetik i jugut (aS'), është po ashtu e ngjashme me fushën magnetike të jugut f(S) që buron nga poli magnetik i jugut (S) i diskut magnetik (dM'), por pasi ndodhet në mes presionit tërheqës të fushës magnetike të veriut f(N) dhe presionit shtytës të fushës magnetike të jugut f(S), fusha antimagnetike e jugut f(aS') buron dhunshëm nga pjesa anësore e diskut magnetik.



(faS')...Fusha antimagnetike e jugut që buron dhunshëm nga pjesa anësore e diskut magnetik.

2. Formimi i polit antimagnetik të veriut (aN) në brendësi të polit magnetik të jugut (S) të diskut magnetik

Ashtu sikur zhvillohen proceset kur vendoset pllaka feromagnetike (1A') mbi polin magnetik të veriut (N), të njejtat zhvillohen edhe kur pllaka e dytë feromagnetike (2A') vendoset mbi polin magnetik të jugut (S) të diskut magnetik (dM').
Përmes magnetometrit vërtetohet saktë se pllaka e magnetizuar (2A') e indukton fushën e saj magnetike të veriut f(IN') në brendësi të polit magnetik të jugut (S) të diskut magnetik.




f(N')....Fusha magnetike e veriut që indukohet nga pllaka e magnetizuar (2A') në brendësi të polit magnetik të jugut (S) të diskut magnetik
(→).. Shigjeta me të kuqe tregon kalimin e fushës magnetike të veriut f(N') nga pllaka e magnetizuar (2A') në brendësi të polit magnetik të jugut (S) të diskut magnetik (dM')

Koncentrimi i fushës së induktuar magnetike të veriut f(IN') në brendësi të polit magnetik të jugut (S), e formon polin e induktuar magnetik të veriut (IN') në brendësi të polit magnetik të jugut (S) të diskut magnetik.
Formimi i polit të indukuar magnetik të veriut (IN') në brendësi të polit magnetik të jugut (S), e transformon polin magnetik të jugut (S) të diskut magnetik (dM') në një *dipol të induktuar magnetik të jugut* *(dIS')* i cili përbëhet nga:

1) poli magnetik i jugut (S), nga i cili buron fusha magnetike e jugut f(S), e cila vepron me forcë tërheqëse (F_2) ndaj polit magnetik të veriut ('N) të sferës së magnetizuar, si dhe


2) poli i induktuar magnetik i veriut (IN'), nga i cili pol buron fusha e induktuar magnetike e veriut f(IN'), e cila vepron me forcë shtytëse (f_2)' ndaj të njëjtit pol magnetik të veriut ('N) të së njëjtës sferë të magnetizuar.

Pasi fusha e induktuar magnetike e veriut f(IN'), që formohet brenda polit magnetik të jugut (S) të diskut magnetik, e kundërshton me forcë shtytëse (f_2') forcën tërheqëse (F_2) të fushës magnetike të jugut f(S) ndaj polit magnetik të veriut (N') të sferës së magnetizuar, është fushë antimagnetike e veriut f(aN'), kurse poli induktuar magnetik i veriut (IN') është pol antimagnetik i veriut (aN').



(f_2')...Forca shtytëse në mes fushës antimagnetike të veriut f(aN') me fushën magnetike të veriut f('N) të sferës së magnetizuar


Fusha antimagnetike e veriut f(aN'), që buron nga poli antimagnetik i veriut (aN'), është po ashtu e ngjashme me fushën magnetike të veriut f(N) që buron nga poli magnetik i veriut (N) i diskut magnetik (dM'), por pasi ndodhet në mes presionit tërheqës të fushës magnetike të jugut f(S) dhe presionit shtytës të fushës magnetike të veriut (N), fusha antimagnetike e veriut f(aN') buron dhunshëm nga pjesa anësore e diskut magnetik.




(faN')...Fusha antimagnetike e veriut që buron dhunshëm nga pjesa anësore e diskut magnetik.

Formimi i dipolit antimagnetik (daM) në brendësi të dipolit magnetik (dM)


Eksperimentalisht vërtetohet se për aq kohë sa mbi polet magnetike të diskut magnetik nuk vendosen pllakat feromagnetike (1A') dhe (2A'), për aq kohë disku magnetik konsiderohet si një dipol magnetik (DM'), nga polet e të cilit burojnë fusha magnetike e veriut f(N) dhe jugut f(S).



Kurse në momentin kur mbi polet magnetike të diskut magnetik (dM'), vendosen pllakat feromagnetike (1A') dhe (2A'), në brendësi të dipolit magnetik (DM') formohet dipoli antimagnetik (daM').




Formimi i dipolit antimagnetik (daM') në brendësi të dipolit magnetik (DM'), e transformon dipolin magnetik (DM'), në një trup magnetik që përbëhet nga dy pole eksterne magnetike të veriut dhe jugut [(eN), (eS)], si dhe dy pole interne antimagnetike të veriut dhe jugut [(iaN'), (iaS')].



(eN)...Poli ekstern magnetik i veriut i dipolit magnetik (DM')
(eS)...Poli ekstern magnetik i jugut i dipolit magnetik (DM')
(iaN)...Poli intern antimagnetik i veriut i dipolit antmagnetik (daM')
(iaS)...Poli intern antimagnetik i jugut i dipolit antmagnetik (daM')

Dy fushat eksterne magnetike [f(eN), f(eS)] që burojnë nga polet eksterne magnetike [(eN), (eS)] veprojnë me forca tërheqëse eksterne [(Fe_1), (Fe_2)] ndaj poleve magnetike ['N), ('S)] të sferës së magnetizuar, kurse dy fushat interne antimagnetike [f(iaN'), f(aS')] që burojnë nga polet interne antimagnetike [(iaN'), (iaS')] veprojnë njëkohësisht me forca interne shtytëse [(fi_1'), (fi_2')] ndaj të njëjtave pole magnetike ['N), ('S)], të të njëjtës sferë të magnetizuar.



(daM')..Dipoli antimagnetik në brendsi të dipolit magnetik (dM')

(Fe_1)...Forca tërheqëse eksterne në mes fushës magnetike të veriut f(eN) të diskut magnetik (dM') me fushën magnetike të jugut f('S) të sferës së magnetizuar,

$$(Fe_1) = [f(eN) \rightarrow \leftarrow f('S)]$$

(fi_1')...Forca shtytëse interne në mes fushës antimagnetike të jugut f(iaS') me fushën magnetike të jugut f('S) të sferës së magnetizuar,

$$(fi_1') = [f(iaS') \leftrightarrow f('S)]$$

(Fe_2)...Forca tërheqëse eksterne në mes fushës magnetike të jugut f(eS) të diskut magnetik (dM') me fushën magnetike të veriut f('N) të sferës së magnetizuar,

$$(Fe_2) = [f(eS) \rightarrow \leftarrow f('N)]$$

(fi_2')...Forca shtytëse interne në mes fushës antimagnetike të veriut f(iaN') me fushën magnetike të veriut f('N) të sferës së magnetizuar,

$$(fi_2) = [f(iaN') \leftrightarrow f('N)]$$

Për shkak se fushat interne antimagnetike [(iaN'), (iaS')] burojnë dhunshëm nga pjesa anësore e diskut magnetik, posedojnë forca shtytëse më të mëdha se sa forcat tërheqëse të fushave magnetike.

Përfundim

Eksperimentet demonstruan se fusha e induktuar magnetike e cila krijohet pasi vendosen pllakat feromagnetike mbi polet e diskut magnetik, shndërrohet në një fushë më vete e cila e kundërvepron fushën magnetike. Kjo konstatohet edhe përmes sferës së magnetizuar që ndodhet në vrimën e diskut. Pikërisht ky është tipari që këtë fushë të re, që krijohet përmes induktimit, e bën të jetë fushë antimagnetike. Po ky fenomen vlen edhe në makrobotë, te trupat qiellor, që do të shtjellohet në librin që jam duke përgatitur për botim.



Sport



FFK-ja organizon kursin e radhës për Licencën UEFA GK B për trajnerë

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës organizon kursin e radhës për trajnerë të portierëve për Licencën UEFA GK B. Kursi do të fillojë më 14 dhjetor 2026, ndërsa moduli i parë do të zhvillohet më 14, 15 dhe 16 dhjetor 2026.

Programi i kursit përfshin ligjërata teorike, aktivitete praktike, monitorime në klube dhe fazën e provimeve. Pjesëmarrja në ligjërata dhe aktivitete praktike është obliguese, ndërsa kandidatët duhet të jenë të përgatitur edhe fizikisht për ndjekjen e kursit.

Pas përfundimit të programit dhe kalimit me sukses të provimeve përkatëse, kandidatët do të pajisen me Licencën UEFA GK B, e cila është një nga kriteret për avancim drejt Licencës UEFA GK A.

Kriteret për aplikim janë: Dëshmi mbi shkollimin (minimum diploma e shkollës së mesme); Vërtetim nga Policia lidhur me dosjen penale; Certifikatë shëndetësore; Kopje e Licencës GK Nacional C dhe UEFA C; Formulari i aplikimit; Dëshmi mbi përvojën si trajner.

"Aplikimi: Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë vetëm online, përmes platformës së aplikimit në faqen zyrtare të Federatës së Futbollit të Kosovës. Konkursi do të jetë i hapur nga data 9 nëntor deri më 27 nëntor 2026. Numri i kandidatëve që do të pranohen në këtë kurs është i kufizuar në 16 pjesëmarrës. Çmimi për pjesëmarrje në kurs është 700 euro. Aplikimet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar, aplikacionet e pakompletuara dhe dokumentet që nuk janë të skanuara qartë nuk do të merren parasysh", ka njoftuar FFK-ja.

FODA: SYNOJMË TA FITOJMË NDESHJEN ME IZRAELIN, TË RINJTË JANË E ARDHMJA E KOMBËTARES

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, në konferencën e parë në kuadër të grumbullimit për dy ndeshjet e nëntorit kundër Izraelit dhe Republikës së Irlandës, në kuadër të Ligës B të Ligës së Kombeve, ka theksuar se objektivi kryesor i Kosovës është të mbetet në Ligën B të Ligës së Kombeve dhe të sigurojë një pozitë më të mirë në vazot e shortit për garat e ardhshme.

"Objektivi ynë është të fitojmë çdo ndeshje, pavarësisht se për cilën ndeshje bëhet fjalë. Por, objektivi kryesor është të mbetemi në Ligën B dhe të jemi në një vazo më të mirë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që fillimisht ta fitojmë ndeshjen kundër Izraelit në shtëpi", ka deklaruar Foda.

